



|   |     |                              |               |
|---|-----|------------------------------|---------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |     | AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT |               |
| AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE                              |     | ANTI-CORRUPTION AGENCY       |               |
| Dep.  | DPK | Nr Prot.                     | 03-02/1196/18 |
| Dep.  |     | Br Prot                      |               |
| Dep.  |     | Prot No                      |               |
| Nr. i faq   |     | Data                         | 19.04.2018    |
| Broj stranica   | 02  | Datum                        |               |
| Nr. pages   |     | Date                         |               |
| PRISHTINE   |     |                              |               |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.04.2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

***I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-823/18 për z. Valon Kashtanjeva – Anëtar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, për shkak se nuk ka prova që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-823/18 për Zyrtarin e lartë, z. Valon Kashtanjeva, Anëtar i Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, është hapur sipas kërkesës nga pala e tretë me pretendimin se ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se është menduar se z. Kashtanjeva duke ushtruar njëkohësisht edhe postin e Drejtorit të Departamentit për te Drejtat e autorit dhe te drejtat e përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka konflikt interesi në emërimin e tij për Anëtar të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, por në fakt emërimi i tij në këtë pozitë është bërë sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Ligji Nr.04/L-106 Për Teatrot, Nr.04/L-106, çështjen e përbërjes dhe mandatit të Këshillit drejtues në nenin 11 paragrafi 2 shprehimisht thotë:

***“Njeri prej shtatë (7) anëtarëve të Këshillit drejtues të teatrove kombëtare duhet të jetë përfaqësues i Ministrisë përkatëse për Kulturë”.***

Edhe Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit bënë përjashtim nga kufizimet e zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera të situatat kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të një funksioni tjetër (Neni 16, paragrafi 1).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

